



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.398/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Ramush Bardiqi - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Valon Sopjani, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 07.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHEN TË PABAZUARA ankesat e parashtuara nga kandidati për anëtar në kuvendin komunal të Komunës së Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (PDK), Valon Sopjani, ZL.Anr.398/2025, ZL.Anr.399/2025, të datës 05.11.2025, të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.398/2025, ZL.Anr.399/2025, të parashtuara nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Valon Sopjani, në të cilat pretendon se në vendvotimet në komunën e Fushë Kosovës, në vendvotimin VP-09-Fushë Kosovë së paku kishte dy vota përmes votimit me postë, ndërsa pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga votimi përmes postës kishte marrë vetëm një vote. Bazuar në deklaratat e dhjetëra votuesve të cilët janë të gatshëm edhe të dëshmojnë, si kandidat konsideron se ka me shumë vota se sa ato që janë publikuar përmes rezultateve përfundimtare. Prandaj ka kërkuar rinumërimin e qendrave të votimit si vendvotimet e VP-09, gjegjësisht VP09/01 dhe VP09/02, 0902-Sh.F.M.U. "Mihail Grameno", 0903-Sh.F.M.U. "Mihail Grameno" Aneksi I, 0914-Sh.F.M.U. "Mihail Grameno" Aneksi III, 0909-Sh.F.M.U. "Daut Bogujevci" Bresje dhe 0901-Sh.F.M.U. "Selman Riza".

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, datë 05.11.2025, theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr 14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve.

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: *17. Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.* Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: *Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.*

Sa i përket pretendimit se pala ankuese mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe të afërmëve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Ndër të tjera ka pretenduar se është votuar nga të afërmit, ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimin e fshehtësisë dhe lirisë së votës, fletëvotimi nuk mund të identifikohet emri i votuesit.

Tutje kanë theksuar se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkëngjitur dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e pretenduara për mospërputhje të rezultateve, pritjet e ankuesit për të marr më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk e argumenton shkeljen e pretenduar. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.398/2025, ZL.Anr.399/2025, të datës 05.11.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZL.A.nr.398/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-i, pasi shqyrtoi ankesat dhe përgjigjet në ankesa, vëren se:

-Ankesat janë të pabazuara.

Paneli pas shqyrtimit të ankesave dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Valon Sopjani, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesat nuk është arritur që të vërtetohet me prova konkrete se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesat, *përkatësisht se votat nuk janë pasqyruar në mënyrë të saktë që ka pasur tjetërsim apo dëmtim të fletëvotimeve*. Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesi i ankesave nuk ka mbështetur pretendimet e saj me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë provë si dëshmi të qartë dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LKP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në qendrat e votimit të komunës së Fushë Kosovës.

Paneli vlerëson se qëndron fakti se është e drejtë e votuesit që pas votimit të deklarohet lirshëm lidhur me votën e tij, apo që të interesohet për votën e tij, por mënyra se si ankuesi e ka përpiluar dëshminë me emrat e votuesve që kinse e kanë votuar, lista si e tillë nuk e përmbushë as kushtin formal dhe as atë përmbajtësor të konsiderohet provë bindëse për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm apo për rinumërim të qendrave të votimit.

Po ashtu është e pa kontestuar se bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LKP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjerë sa sipërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë të votës. Në Nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se *"Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë në një mënyrë, të mbajë atë përgjegjëse për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim"*

Duhet cekur se lidhur me deklarata të votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: *"deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit"*.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj me prova konkrete, të ligjshme se ka pasur mungesë të votave, por se pretendimet e ankuesit janë më shumë pritshmëri e tij për më shumë vota, e jo që në realitet ka pasur mungesë të votave.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesa, ankuesi nuk ka arritur që ti provoj.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.398/2025, datë 07.11.2025

Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.